



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/96
Datë: 29/6/2021

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 132 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037, Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e datës 24. 06. 2021, miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR STUDIMET E DOKTORATËS

Dispozitat e përgjithshme
Neni 1

- (1) Me Rregulloren për studime të doktoratës (në vazhdim: rregullorja) rregullohen organizimi dhe realizimi i studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" (në vazhdim: universiteti), institucioni përgjegjës për organizimin e studimeve, formati dhe kohëzgjatja e studimeve, kriteret për regjistrimin në studime, mënyra e realizimit të studimeve, mësimi dhe hulumtimi, procedura e paraqitjes, e vlerësimit dhe e mbrojtjes së punimit të doktoratës, të drejtat dhe obligimet e studentit në studime të doktoratës (në vazhdim: doktoranti), të drejtat dhe obligimet e mentorit, mënyrat e sigurimit të cilësisë, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me organizimin dhe realizimin e studimeve të doktoratës.
- (2) Me këtë rregullore përcaktohen kriteret e domosdoshme për aktivitetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 2

Kuptimi i nocioneve sipas kësaj rregulloreje:

- (1) Këshilli i studimeve të doktoratës në nivel të njësisë akademike (fakultetit) është Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike, ndërsa në nivel të universitetit është Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës (KQSD).
- (2) Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike përbëhet nga 5 ose 7 anëtarë nga radhët e profesorëve me thirrjen së paku profesor i asociuar, të cilët përfaqësojnë departamentet¹ përkatëse të njësisë akademike. Në mungesë të profesorëve të asociuar, anëtarë të këshillit të studimeve të doktoratës mund të emërohen edhe profesorët asistentë. Mbledhja e parë (konstituive) ftohet dhe udhëhiqet nga dekani i njësisë akademike. Pas konstituimit të këshillit të studimeve të doktoratës, ai nga radhët e veta e zgjedh kryetarin.
- (3) Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës ka këtë përbërje:
 - Rektori;

¹ Rolin e departamentit sipas kësaj rregulloreje, varësisht nga njësiti akademike, mund ta ushtrojnë degët, përkatësisht katedrat.

- Prorektori për kërkime shkencore;
- Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i shkencave në Fakultetin Filozofik;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i shkencave filologjike;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i shkencave të inxhinierisë mekanike ose të inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i shkencave të inxhinierisë së ndërtimit ose të arkitekturës;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i arteve;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i shkencave matematike-natyrore;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i mjekësisë;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i shkencave të bujqësisë dhe veterinës;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i shkencave juridike;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i shkencave ekonomike;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i edukimit fizik dhe sportit;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga lëmi i shkencave të edukimit;
- Drejtori i Zyrës për Çështje Akademike (ZQA) - pa të drejtë vote.

- (4) Anëtarët e Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës i propozon rektori dhe i zgjedh senati.
- (5) Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës kryesohet nga rektori. Në mungesë të tij/saj, këshilli kryesohet nga prorektori për kërkime shkencore. Në rastin e votave të barabarta, vota e kryesuesit është përcaktuese.
- (6) Institucioni përgjegjës i studimeve është një ose më shumë njësi akademike, një ose më shumë universitete brenda dhe jashtë vendit, të cilat i organizojnë dhe i realizojnë studimet e doktoratës dhe të cilat e përfundojnë procedurën e arritjes së doktoratës shkencore/artistike.
- (7) Mentori është personi i emëruar me titull shkencor-mësimor ose artistik-mësimor, i cili e udhëheq doktorantin gjatë punimit të disertacionit të doktoratës.
- (8) Dosja e doktorantit është dosja e cila i përmban të gjitha shënimet qenësore të doktorantit prej momentit të pranimin të tij e deri te promovimi. Njësia akademike përkatëse është përgjegjëse për mbledhjen dhe për ruajtjen e të dhënave në dosje.

Neni 3

- (1) Studime të doktoratës ofrojnë njësitë akademike (fakultetet) dhe/ose universiteti/universitetet në një a më shumë lëmenj shkencorë, nëse së paku gjysma e personelit akademik të angazhuar në atë program, janë në marrëdhënie të rregullt pune në UP.
- (2) Studimet e doktoratës mund të ofrohen dhe të realizohen vetëm në ata lëmenj shkencorë, në të cilët institucioni përgjegjës ka arritje të pranuar ndërkombëtare në kërkimet shkencore, përkatësisht në krijimtarinë artistike, të dëshmuara me punime të botuara në revista ndërkombëtare

shkencore dhe të indeksuara në platforma kredibile ndërkombëtare, përkatësisht të prezantuara në institucione të dëshmuara kulturore/artistike jashtë vendit, në përputhje edhe me standardet në fuqi të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA).

- (3) Studimet e doktoratës në fushën përkatëse mund të realizohen pas akreditimit të tyre nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).
- (4) Me studimet e doktoratës udhëheq Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë përkatëse akademike.
- (5) Karakteristikat themelore të studimeve të doktoratës në universitet janë hulumtimi dhe të mësuarit nëpërmjet hulumtimit, ndërkombëtarizimi, transparenca, vlerësimi ndërkombëtar i cilësisë dhe konkurrenca ndërkombëtare.
- (6) Me qëllim të sigurimit të cilësisë në studimet e doktoratës dhe nxitjes së lëvizshmërisë/mobilitetit të doktorantëve dhe të stafit akademik, UP-ja është e hapur për çdo formë të bashkëpunimit me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit.

Qëllimet e studimeve të doktoratës **Neni 4**

Qëllimet e studimeve të doktoratës janë:

- (1) Krijimi i njohurive të reja dhe relevante shkencore ose i praktikave artistike, si dhe zbatimi i tyre;
- (2) Arsimitimi i hulumtuesve dhe i studiuesve të dalluar në fusha të caktuara shkencore ose artistike;
- (3) Aftësimi i doktorantëve për punë të pavarur kërkimore/artistike, për hulumtime të pavarura dhe për vlerësime kritike të punës së të tjerëve;
- (4) Arritja e njohurive, përvojave dhe shkathtësive, të cilat duhet t'u mundësojnë doktorëve të shkencave që, në mënyrë kreative dhe të mbështetur në hulumtime, të ofrojnë kontribut origjinal dhe domethënës në fushat përkatëse të dijes;
- (5) Ndërkombëtarizimi i punës kërkimore/artistike në universitet.

Mësimi dhe hulumtimi në studimet e doktoratës **Neni 5**

- (1) Komponenti thelbësor i studimeve universitare të doktoratës është kërkimi dhe krijimi shkencor/artistik.
- (2) Format e punës të obligueshme në studimet e doktoratës, me qëllim të zhvillimit të punës kërkimore, mendimit kritik, përvetësimit të metodologjisë dhe shkathtësive të përgjithshme, përveç tjerash, janë: seminarët kërkimore, puna eksperimentale, punëtoritë dhe grupet e diskutimit.
- (3) Mësimi në formë të ligjëratave nuk mund të kalojë 20 përqindëshin e ngarkesës së përgjithshme të paraparë me programin e studimeve dhe të llogaritur sipas sistemit evropian të transferimit të kredive (ECTS).

- (4) Sipas mundësive dhe në bazë të kushteve të përcaktuara paraprakisht, ndjekja e mësimave në studimet e doktoratës është e hapur për të gjithë doktorantët e universitetit. Disa pjesë të kërkimeve dhe të mësimave në studimet e doktoratës mund të ndiqen edhe nga doktorantët e universiteteve të tjera, sipas kushteve të parapara në kontratën paraprakisht të nënshkruar ndërmjet universiteteve në fjalë.
- (5) Me qëllim të arritjes së interdisiplinaritetit dhe në bazë të arsytimit dhe pëlqimit të mentorit, si dhe të pëlqimit të Këshillit të studimeve të doktoratës, doktorantët mund të kryejnë pjesë të caktuara të kërkimit dhe të krijimtarisë artistike edhe në njësitë e tjera akademike të universitetit ose në institucione të tjera përkatëse brenda dhe jashtë vendit.
- (6) Këshilli i studimeve të doktoratës mund t'u caktojë doktorantëve lëndë plotësuese nga grupi i lëndëve brenda programit të akredituar për arritjen e diturive themelore, të domosdoshme për vijimin dhe përfundimin e studimeve, por jo me qëllim të zëvendësimit të ECTS kredive të parapara të arrihen me aktivitete të formave tjera.

Format e studimeve të doktoratës

Neni 6

- (1) Studimet e doktoratës mund të organizohen në njërin prej këtyre formave:
 1. Studimet e doktoratës, për të cilat institucion përgjegjës është vetëm një njësi akademike ose universiteti;
 2. Doktorata e dyfishtë, në të cilën doktoranti i merr dy diploma dhe për të cilën është i obliguar edhe mentorimi i dyfishtë (modeli: cotutelle de thèse). Aplikohet në rastet kur me marrëveshje të veçantë, doktoranti regjistrohet në studimet e doktoratës në dy universitetet partnere dhe të dy universitetet emërojnë mentorin përkatës për doktorantin. Procedurat e regjistrimit të doktorantëve dhe realizimit të studimeve të doktoratës parashihen në marrëveshjen e veçantë të lidhur ndërmjet dy universiteteve.
 3. Studimet në bashkëpunim me dy a më shumë universitete, nga të cilat vetëm një universitet është institucion përgjegjës;
 4. Studimet sipas modelit të ashtuquajtur sandviç, në të cilin doktoranti i regjistron studimet në një universitet dhe merr diplomën e atij universiteti, ndërsa kërkimet i kryen në më shumë institucione dhe mund të ketë më shumë mentorë në cilësinë e bashkëmentorëve (komentorëve);
 5. Studimet e përbashkëta si program i akredituar i dy ose më shumë universiteteve, nga të cilat së paku një universitet është jashtë Republikës së Kosovës. Secili universitet merr pjesë në regjistrimin e doktorantëve, ndërsa doktoranti mund të fitojë një diplomë të vetme të dy ose më shumë universiteteve ose diplomën e universitetit, në të cilin i ka regjistruar studimet e doktoratës, në të cilën shkruan se studimet kanë qenë të përbashkëta me partner ndërkombëtar.
- (2) Nuk lejohet transferimi i studentëve të doktoratës nga një njësi akademike në tjetrën brenda Universitetit të Prishtinës, e as nga universitetet e tjera në Universitetin e Prishtinës. Studentët pranohen vetëm në bazë të konkurrimit në konkursin e shpallur.

Numri i studentëve, konkursi dhe kushtet e regjistrimit në studime të doktoratës
Neni 7

- (1) Njësitë akademike e propozojnë numrin e studentëve për regjistrim, në pajtim me kushtet e përcaktuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, ndërsa senati e merr vendimin përfundimtar për numrin e studentëve dhe shpalljen e konkursit publik, duke pasur parasysh kapacitetet hulumtuese, mësimore dhe mentoriale të njësisë akademike.
- (2) Senati i universitetit, me propozimin e njësisë akademike dhe pas shqyrtimit në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës, merr vendim përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Emrat e kandidatëve të pranuar, me të gjitha të dhënat e kriterëve të përzgjedhjes, shpallen publikisht në uebfaqen e njësisë akademike dhe në uebfaqen e universitetit.
- (3) Kushtet e regjistrimit i përcakton senati i universitetit, me propozimin e KQSD-së dhe në pajtim me këtë rregullore.
- (4) Konkursi publik për regjistrim në studime të doktoratës shpallet nga senati i universitetit. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë kandidatët me notë mesatare jo më të ulët se 8.00 në secilin nivel të studimeve paraprake veç e veç, të diplomuar në njërin nga nivelet vijuese:
 1. Të diplomuarit para hyrjes në fuqi të studimeve sipas Deklaratës së Bolonjës, të cilët duhet të jenë magjistra të shkencës përkatëse;
 2. Të diplomuarit pas hyrjes në fuqi të studimeve në bazë të Deklaratës së Bolonjës - niveli i studimeve master shkencor;
 3. Të diplomuarit që kanë së paku 300 kredite European Credit Transfer System (ECTS);
- (5) Parakusht për vlerësimin e kandidatëve është dorëzimi i dokumentacionit përkatës nga ana e tyre ku, përveç tjerash, përfshihen: letra motivuese, në të cilën arsyetohet interesi për kërkime shkencore/artistike në lëmin përkatës, koncepti ideor i hulumtimit, dëshmitë lidhur me suksesin në secilin nivel të studimeve paraprake, dëshmitë për njohjen e gjuhës angleze, dëshmitë lidhur me publikimet përkatëse dhe rekomandimet e dy profesorëve nga lëmi përkatës. Lista e plotë e dokumentacionit të nevojshëm për vlerësimin e kandidatëve specifikohet në konkursin publik.
- (6) Kriteret e përcaktimit të përparësisë në radhitje janë:
 1. Kandidatët duhet t'i kenë të përfunduara studimet paraprake në njësinë akademike përkatëse, në fushën e njëjtë ose të afërt me studimet e doktoratës. Fushat e afërta përcaktohen nga njësia akademike përkatëse, vlejné për tërë periudhën e akreditimit të programit përkatës dhe publikohen në konkurs në kuadër të kushteve të veçanta për njësinë akademike përkatëse. Vlerësimi i fushave të kandidatëve, të cilët studimet i kanë kryer në fakultetet ose universitetet tjera, bëhet nga ana e Këshillit të studimeve të doktoratës, para se të njëjtit t'i nënshtrohen provimit pranues.
 2. Nota mesatare gjatë studimeve në nivelin bachelor dhe master, përkatësisht nota mesatare e studimeve të integruara, vlerësohet maksimalisht me 30 pikë, të cilat llogariten duke shumëzuar notën mesatare aritmetike të studimeve bachelor dhe master me 3.
 3. Magjistratura nga lëmi shkencor ose specializimi relevant profesional vlerësohet me 5 pikë;

4. Aktiviteti kërkimor- shkencor, siç dëshmohet me botimet dhe prezantimet si në vijim, vlerësohet me një vlerë maksimale deri në 15 pikë:
- a) Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuara në Web of Science (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe/ose SCOPUS (Q1, Q2): autori i parë/korrespondent 5 pikë, të tjerët 2 pikë.
 - b) Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuar në SCOPUS (Q3, Q4) ose SCOPUS pa specifika të quartalit: autori i parë/korrespondent 4 pikë, të tjerët 1.5 pikë.
 - c) Për çdo artikull të botuar në pesë vjetët e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara në platformat e specifikuara në rregulloren në fuqi për procedurat përzgjedhëse lidhur me personelin akademik: autori i parë 3 pikë, i dyti 2 pikë të tjerët 1 pikë.
 - d) Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit në revista akademike vendore, që botohen nga Universiteti i Prishtinës ose nga qendrat apo institutet e tij, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, nga Instituti Albanologjik dhe nga Instituti i Historisë, të cilat i nënshtrohen recensionit profesional: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.
 - e) Për libër universitar të botuar në pesë vjetët e fundit nga lëmi i ngushtë: autori kryesor 5 pikë, bashkautori 3 pikë gjithsej. Monografia në fushën ku aplikon kandidati vlerësohet me 4 pikë.
 - f) Për çdo prezantim gojor të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore të indeksuar dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.
 - g) Për çdo prezantim në formë poster të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore të indeksuar dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.
 - h) Për çdo prezantim gojor në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) shkencore me karakter vendor: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.
5. Publikimet në revista dhe botues të dyshimtë, siç janë të definuara në rregulloren në fuqi për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin e personelin akademik, nuk merren parasysh. Në këtë rregullore, ky kufizim është i aplikueshëm edhe në rastet tjera kur bëhet fjalë për revista dhe botues të tyre.
6. Njësitë akademike mund të parashtrajnë për miratim nga senati kritere shtesë, varësisht nga programi i studimeve të doktoratës, në përputhje me Statutin e UP-së dhe me këtë rregullore.
7. Në rastin e pikëve të barabarta, përparësi i jepet kandidatit që është staf i rregullt i UP-së.
8. Provimi pranues organizohet dhe administrohet nga njësitë akademike, duke respektuar standardet më të larta akademike. Në rastet e prezencës së konfliktit të interesit, duhet të evitohet në tërësi përfshirja e personelit përkatës në të gjitha fazat e provimit pranues. Në rastet e tilla senati i universitetit mund të kërkojë nga fakulteti që të marrë masa shtesë me qëllim të evitimit të diskreditimit të provimit pranues.

9. Kandidatët kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit pranues vetëm nëse paraprakisht komisioni përkatës i fakultetit konstaton se të njëjtit i plotësojnë kushtet e konkursit dhe kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar.
10. Provimi pranues përfshin provimin lidhur me aspektin profesional/shkencor dhe provimin lidhur me nivelin e njohjes së gjuhës angleze.
11. Nga pjesa profesionale e provimit pranues kandidatët mund të fitojnë maksimalisht 30 pikë.
12. Pjesa e provimit pranues lidhur me gjuhën angleze është e njëjtë për të gjitha njësitet akademike dhe është e obligueshme për të gjithë kandidatët. Nëse kandidati dëshmon që ka certifikatë ndërkombëtare TOEFL me së paku 79 pikë (ose IELTS me së paku 5.65 pikë), i njëjti me automatizëm merr 10 pikë, ndërsa pikët tjera lidhur me gjuhën angleze shtohen varësisht nga suksesi i treguar në provimin pranues - pjesën e gjuhës angleze. Njohuria e gjuhës angleze vlerësohet maksimalisht me 20 pikë.
13. Kandidatët kanë të drejtë të renditen në listë pasi të kenë kaluar pragun e kalueshmërisë të provimit pranues, përkatësisht pasi të kenë arritur së paku 50% të pikëve të pjesës profesionale dhe 50% të pikëve të pjesës lidhur me gjuhën angleze.
14. Njësitet akademike mund të vendosin kushte të veçanta (kriteret), nëse të njëjtat nuk bien ndesh me Statutin e UP-së dhe me këtë rregullore. Kushtet e veçanta specifikohen në konkursin përkatës të publikuar pas akreditimit të programit të doktoratës dhe vlejnë për tërë periudhën e akreditimit.

Kohëzgjatja dhe fazat e studimeve të doktoratës

Neni 8

- (1) Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vjet, përkatësisht organizohen në gjashtë semestra. Studimet e doktoratës duhet të përmbillen me mbrojtjen publike të temës së doktoratës më së largu brenda gjashtë (6) vjetësh nga dita e regjistrimit të tyre. Me propozim të arsyetuar të Këshillit të studimeve të doktoratës, këshillit të fakultetit dhe Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës si dhe pas aprovimit nga ana e senatit, studimet e doktoratës mund të vazhdojnë edhe për një vjet. Nëse brenda kësaj periudhe doktoranti nuk arrin t'i përfundojë studimet e doktoratës nëpërmjet mbrojtjes publike të punimit të doktoratës, i njëjti e humb statusin e doktorantit.
- (2) Për studentët, të cilët kanë përfunduar magjistraturën shkencore, studimet e doktoratës në lëmin e njëjtë zgjasin jo më pak se dy vjet. Në rastin e tillë magjistratura ekuivalentohet me deri 1/3 e numrit të përgjithshëm të kredive të parapara në studimet e doktoratës. Për transferimin e kredive vendos Këshilli i doktoratës i njësisë akademike, në bazë të kërkesës së doktorantit. Afatet e përfundimit të studimeve të doktoratës si në paragrafin (1) të këtij neni vlejnë edhe për këtë grup të studentëve.
- (3) Për programet e akredituara dhe ato që janë në proces të akreditimit, grumbullimi i kredive ECTS bëhet në përputhje me programet përkatëse. Për programet të cilat futen në proces të akreditimit/riakreditimit pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, grumbullimi i kredive ECTS bëhet siç parashihet në këtë nen.
- (4) Në semestrin e parë doktoranti i merr 30 ECTS nga provimet e 3 deri 6 lëndëve profesionale/shkencore të programit, të cilin e ka regjistruar. Në mesin e lëndëve të tilla duhet të

jetë obligative së paku një lëndë lidhur me etikën e kërkimit shkencor dhe metodologjinë e hulumtimit shkencor, me së paku 6 ECTS kredi.

- (5) Në fillim të semestrit të dytë doktoranti, në konsultim me mentorin potencial, propozon fushën e ngushtë të hulumtimit dhe temën potenciale të punimit të doktoratës (Formulari F1). Propozimi i kandidatit për temën dhe mentorin potencial (Formulari F1) shqyrtohet në këshillin e fakultetit, bazuar në vlerësimin e këshillit të doktoratës dhe të departamentin përkatës. Këshilli i fakultetit, bazuar në kriteret e specifikuar në këtë rregullore, mund t'i rekomandojë doktorantit rishqyrtim të propozimit për mentorin dhe temën, para se doktoranti të thellohet në fushën e hulumtimit. Në këtë semestër doktoranti i merr 6 ECTS nga lëndët zgjedhore të parapara në programin studimor, respektivisht të zgjedhura në bashkëpunim me mentorin potencial. Bazuar në nivelin e kryerjes së obligimeve të parapara në lëndën përkatëse, mësimdhënësi përkatës vendos në SEMS vlerësimin kaloi/nuk kaloi.

Pjesën tjetër të kredive (24 ECTS) doktoranti duhet ta marrë nëpërmjet kombinimit të aktiviteteve vijuese:

- Zhvillimi i hulumtimeve paraprake nëpërmjet studimit të thelluar në 2 fusha të ndërlidhura me temën potenciale të doktoratës dhe përmbledhja e gjetjeve në seminare përkatëse. Studenti, në konsultim me mentorin potencial, zgjedh mësimdhënësin e fushës, me të cilin kandidati bashkëpunon në hartimin e seminarit në fushat përkatëse. Mentori potencial, së bashku me mësimdhënësin e fushës, kujdeset që kandidati, gjatë hartimit të seminarit, të realizojë aktivitetet vijuese për të marrë ECTS përkatëse:
 - Kërkim empirik në terren ose laborator (2 ECTS);
 - Prezantim të rezultateve paraprake të kërkimit dhe diskutimi i tyre me bartësin e seminarit dhe me mentorin potencial (2 ECTS);
 - Paraqitje të rezultateve para kolegëve në konferencë të doktorantëve, të organizuar nga njësi akademike (2 ECTS) dhe
 - Dorëzim final të seminarit në formë të studimit me shkrim (2 ECTS).

Mentori potencial regjistron në SEMS titullin e seminarit përkatës, mësimdhënësin e fushës dhe numrin e kredive (8 ECTS). Nëpërmjet këtij aktiviteti, studenti mund të realizojë deri 2 seminare dhe të marrë deri 16 ECTS.

- Përgatitja dhe prezantimi i rezultateve të hulumtimeve të thelluara në fushat e afërta me temën potenciale, në konferenca vendore ose rajonale, 1 konferencë 4 ECTS;
 - Qëndrim hulumtimi në laboratorë/institucione shkencore/ klinika (jashtë vendit), prezantim para departamentit të përvojës së fituar dhe arsyetimi i saj në lidhje me fushën e studimit të doktorantit, deri 10 kredi (2 javë qëndrim vlerësohet 5 ECTS);
 - Qëndrim për nevoja praktikimi, testimi dhe verifikimi të gjetjeve të hulumtimeve paraprake, në organizata/institucione vendore/ndërkombëtare, deri 6 kredi (1 muaj qëndrim, vlerësohet me 3 ECTS). Qëndrimi duhet të konfirmohet nga organizata/institucioni pritës.
- (6) Për regjistrimin e semestrit të tretë, doktoranti duhet të ketë të grumbulluara së paku 36 ECTS në dy semestrat paraprakë. Fillimisht doktoranti përgatit planin e realizimit të projektpropozimit dhe e mbron para mentorit (6 ECTS). Bazuar në aprovimin e projektpropozimit nga ana e mentorit, doktoranti bën kërkesën (Formulari F2) për shqyrtimin e mentorit dhe projektpropozimit lidhur me temën e doktoratës. Pas kalimit të procedurave të aprovimit të mentorit dhe projektpropozimit,

(këshillin e doktoratës të njësisë akademike, këshillin e njësisë akademike, KQSD dhe senat), doktoranti merr 24 ECTS.

- (7) Për regjistrimin e semestrit të katërt doktoranti duhet t'i ketë dhënë të gjitha provimet dhe t'i ketë grumbulluar nga semestrat paraprakë së paku 90 ECTS. Në tre semestrat e mbetur, doktoranti merr 90 ECTS përmes:
- a) Publikimit si autor i parë i së paku një punimi të një pjese të rezultateve të doktoratës në revista ndërkombëtare të indeksuara në përputhje me rregulloren në fuqi për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin e personelit akademik (20 ECTS);
 - b) Publikimit si autor i parë i së paku një punimi të një pjese të rezultateve të doktoratës në revista akademike vendore, që botohen nga Universiteti i Prishtinës ose nga qendrat apo institutet e tij, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, nga Instituti Albanologjik dhe nga Instituti i Historisë, dhe të cilat i nënshtrohen recensionit profesional (5 ECTS);
 - c) Së paku 1 prezantim jashtë vendit, si autor i parë në tubime shkencore (konferenca, kongrese, etj.), me karakter ndërkombëtar (5 ECTS, për doktorantët të cilët kanë publikuar së paku një punim në revista vendore) përkatësisht së paku 2 prezantime si autor i parë në tubime shkencore (konferenca, kongrese, etj.), me karakter ndërkombëtar dhe kombëtar (10 ECTS, për doktorantët të cilët nuk kanë të publikuar së paku një punim në revista vendore);
 - d) Përfundimit dhe mbrojtjes publike të punimit të doktoratës (60 ECTS).

Mentorimi Neni 9

- (1) Për programet të cilat janë në implementim e sipër, të drejtë mentorimi kanë mësimdhënësit, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregulloren, e cila ka qenë në fuqi në kohën e akreditimit të programeve të tilla.
- (2) Për programet të cilat akreditohen nga momenti i futjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të drejtë për të udhëhequr kandidat për doktoratë ka:
 1. Mësimdhënësi me titull akademik profesor i rregullt (prof. dr.) ose profesor i asociuar (prof. asoc.), i cili është në marrëdhënie të rregullt pune në UP dhe i cili ka së paku tri (3) punime në fushën përkatëse si autor i parë ose korrespondent, të botuara në 5 vjetët e fundit në revista të indeksuara në Web of Science (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe/ose SCOPUS.
 2. Përrjashtimisht, me kërkesë të këshillit të fakultetit, për mentor mund të angazhohet edhe mësimdhënësi me titull akademik profesor asistent (prof. ass.), me së paku 3 vjet përvojë në hulumtim, nëse ka së paku tri (3) punime në fushën përkatëse si autor i parë ose korrespondent, të botuara në 5 vjetët e fundit, në revista të indeksuara në Web of Science (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe/ose SCOPUS.
 3. Dëshmia për publikimin e punimeve duhet të sillet në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës;
 4. Publikimet në revista dhe botues të dyshimtë, siç janë të definuara në rregulloren në fuqi për procedurat përzgjedhëse lidhur me personelin akademik, nuk merren parasysh;

5. Mentor, në rast të veçantë, mund të jetë edhe profesori emeritus, ndërsa vendimin për këtë e merr senati, me propozim të Këshillit të doktoratës të njësisë akademike, në kuadër të së cilës organizohen studimet ose të këshillit të lëmit shkencor.
- (3) Mentori, pa përjashtim, duhet të jetë nga fusha e ngushtë shkencore nga e cila përgatitet doktorata. Në këtë aspekt merret parasysh fusha e publikimeve shkencore të mentorit dhe kurset, të cilat i njëjti i ligjëron në të tri nivelet e studimit.
- (4) Për të siguruar cilësi të punimit të doktoratës, në rast se është nevoja (p.sh. hulumtimi ndërdisiplinor, zhvillimi i kërkimit apo i krijimit artistik në disa institucione), mund të propozohet emërimi i bashkëmentorit (komentorit) nga ndonjë universitet tjetër.
- (5) Bashkëmentori duhet të posedojë kualifikimet e njëjta ose ekuivalente me mentorin.
- (6) Bashkëmentori e bashkudhëheq doktorantin në çështjet e dakorduara paraprakisht me mentorin.
- (7) Një bashkëmentor nuk mund të jetë i përfshirë në mentorimin e më shumë se një doktoranti njëkohësisht.
- (8) Për një punim të doktoratës nuk mund të emërohen më shumë se një bashkëmentor, përveç rasteve specifike (neni 6, paragrafi 4).
- (9) Një mentor mund të marrë për udhëheqje më së shumti dy doktorantë të regjistruar brenda një viti akademik, por jo më shumë se tre (3) doktorantë njëkohësisht.
- (10) Para se ta marrë detyrën e mentorit për herë të parë, atëherë kur universiteti e konsideron të nevojshme, secili mentor duhet ta kalojë punëtorinë e mentorimit, të cilën e organizon universiteti.
- (11) Mësimdhënësi i një njësie akademike të Universitetit të Prishtinës (UP) mund të jetë mentor në ndonjë universitet tjetër, nëse ka miratim me shkrim nga këshilli i njësisë akademike të UP-së.
- (12) Për mentor/bashkëmentor nuk mund të propozohet profesori i pensionuar.
- (13) Mentori/bashkëmentori i cili është emëruar në këtë funksion para se të pensionohet ka të drejtë ta kryejë mentorimin deri në fund, por jo më larg se deri në moshën 70-vjeçare.

Obligimet e mentorit **Neni 10**

- (1) Mentori e ka obligim ta udhëheqë doktorantin gjatë punës së punimit të doktoratës, ta përcjellë cilësinë e punës së doktorantit, ta përkrahë publikimin e punimeve të tij dhe pjesëmarrjen në projekte shkencore dhe artistike.
- (2) Në rastet e caktuara, kur doktoranti udhëhiqet nga më shumë se një mentor, secili prej tyre i mban përgjegjësitë e veta për pjesën e hulumtimit, paraprakisht të përcaktuar dhe për procedurën e punës në punimin e doktoratës.
- (3) Mentori ka obligim që një herë në vit t'i paraqesë raport për punën e doktorantit Këshillit për studime të doktoratës të njësisë akademike, në formular të universitetit.

Obligimet dhe të drejtat e doktorantit

Neni 11

- (1) Doktoranti është i obliguar që një herë në vit, në formular të universitetit, t'ia paraqesë Këshillit të studimeve të doktoratës raportin për punën e tij (me mundësi të prezantimit të hulumtimit).
- (2) Doktoranti ka të drejtë një herë gjatë studimeve të bëjë kërkesë me shkrim për ndërrim të mentorit dhe temës, por jo pas aprovimit në senat të projektpropozimit dhe temës. Përjashtimisht, në rast të paaftësisë së mentorit për vazhdimin e mentorimit (të dëshmuar me vërtetim të mjekut specialist), në rast të vdekjes së tij ose në rast të konstatimit të shkeljeve përkatëse për mentorin nga ana e instancave përkatëse ligjore brenda ose jashtë UP-së, kandidati mund të kërkojë nga senati lejimin e ndërrimit të mentorit (dhe të temës, sipas nevojës), edhe në faza të mëvonshme. Në rastin e tillë, procedura e aprovimit të mentorit dhe temës përsëritet.
- (3) Doktoranti është i obliguar që të grumbullojë numrin e nevojshëm të kredive (ECTS), nëpër fazat përkatëse të studimit, siç parashihet në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

Procedura e paraqitjes së temës, mentorit dhe projektpropozimit të doktoratës

Neni 12

- (1) Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoratës, përkatësisht në semestrin e dytë, doktoranti e propozon mentorin (sipas rastit edhe mentorin tjetër ose bashkëmentorin) dhe temën e punimit të doktoratës. Propozimi i tillë (formulari F1) bëhet në konsultim me mentorin potencial dhe duhet të përmbajë edhe fushën e ngushtë të hulumtimit.
- (2) Në kuadër të formularit për paraqitjen e temës dhe mentorit (F1) doktoranti nënshkruan edhe deklaratën se nuk ka paraqitur punim doktrate me të njëjtën temë në studime të tjera universitare, përkatësisht në ndonjë universitet tjetër.
- (3) Propozimi i kandidatit për temën dhe mentorin potencial shqyrtohet në departamentin përkatës, Këshillin e studimeve të doktoratës dhe këshillin e fakultetit i cili, bazuar në kriteret e specifikuar në këtë rregullore, mund t'i rekomandojë doktorantit rishqyrtim të propozimit për mentorin dhe temën, para se doktoranti të thellohet në fushën e hulumtimit.
- (4) Vlerësimi përfundimtar i temës dhe mentorit bëhet në semestrin e tretë, në kuadër të vlerësimit të projektpropozimit të temës së doktoratës. Kërkesa për vlerësimin e projektpropozimit (formulari F2), përveç shënimeve formale lidhur me doktorantin, duhet të përmbajë edhe të dhënat vijuese:
 - Titullin e temës së propozuar,
 - Të dhënat për mentorin (sipas rastit edhe për mentorin e dytë, përkatësisht bashkëmentorin),
 - Shtjellimin e temës dhe qëllimit të hulumtimit,
 - Përmbledhjen e hulumtimeve të kryera deri më tani lidhur me temën e doktoratës,
 - Hipotezat e fillimit të hulumtimit,
 - Materialin, metodologjinë dhe planin e hulumtimit,
 - Kontributin dhe rezultatet e pritura shkencore të hulumtimit të propozuar,
 - Literaturën e cituar.

- (5) Këshilli i njësisë akademike, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës, e emëron komisionin për vlerësimin e temës dhe e miraton propozimin për mentorin në afat prej një muaji nga data e protokollimit të kërkesës së parashtruar. Ky komision përbëhet prej tre (3) anëtarëve, nga të cilët së paku një anëtar nuk duhet të jetë mësimdhënës i studimeve në fjalë e as i punësuar në njësinë akademike (fakultetin), e cila është përgjegjëse e studimeve. Mentori i propozuar nuk mund të emërohet për kryetar të komisionit.
- (6) Komisioni për vlerësimin e temës e jep vlerësimin për kontributin e pritur shkencor/artistik origjinal dhe për mundësinë e zbatimit të kërkimit, më së largu një muaj pas paraqitjes së kërkesës.
- (7) Projektpropozimi i punimit të doktoratës mbrohet para Këshillit të studimeve të doktoratës të njësisë akademike, para komisionit për vlerësim dhe mentorit të propozuar, jo më larg se 15 ditë pas dorëzimit të raportit të komisionit për vlerësim.
- (8) Këshilli i njësisë akademike, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës, ia propozon temën dhe mentorin për shqyrtim KQSD-së. KQSD-ja, brenda një (1) muaji, duhet ta shqyrtojë propozimin e Këshillit të studimeve të doktoratës. Pas shqyrtimit të propozimit të këshillit të njësisë akademike, KQSD-ja mund të:
- a) Rekomandojë pranimin e propozimit origjinal të këshillit të njësisë akademike;
 - b) Kërkojë nga doktoranti që ta plotësojë/ndryshojë temën;
 - c) Kërkojë nga këshilli i njësisë akademike të propozojë mentor tjetër.
- (9) Në rast të rekomandimit pozitiv nga ana e KQSD-së, senati duhet të vendosë rreth propozimit për temën dhe mentorin brenda një (1) muaji nga momenti i rekomandimit të tillë. Bazuar në vlerësimin pozitiv nga ana e senatit, doktorantit i dorëzohet vendimi përkatës për aprovim të temës së punimit të doktoratës (formulari F3).
- (10) Të gjitha hulumtimet shkencore në njerëz ose në shtazë doemos duhet të jenë në pajtim me dispozitat e rregullores së Komisionit të Etikës, duhet ta kenë lejen e Komisionit të Etikës të fakultetit apo universitetit, si dhe të institucionit në të cilin zbatohet hulumtimi; pëlqimin e të gjithë të hulumtuarve veç e veç (pacientëve, përkatësisht vullnetarëve), nëse janë në gjendje të aftë ta bëjnë këtë, përkatësisht të kujdestarëve të tyre ose të përfaqësuesit ligjor të tyre.
- (11) Nëse doktoranti bën kërkesë për ndërrim të mentorit dhe temës, e njëjta duhet të dorëzohet në formë të shkruar dhe të arsyetuar së bashku me deklaratën përkatëse me shkrim të mentorit të deriatëhershëm (formulari F4). KQSD-ja i propozon senatit vendimin përkatës lidhur me kërkesën e tillë të doktorantit.

Punimi i doktoratës Neni 13

Punimi i doktoratës është punim origjinal shkencor/artistik, i cili i nënshtrohet vlerësimit publik shkencor/artistik.

Format e punimit të doktoratës

Neni 14

Format e punimit të doktoratës janë:

- (1) Monografi shkencore;
- (2) Në formë të përmbledhjes të së paku tri (3) punimeve shkencore, të cilat kandidati i publikon në cilësinë e autorit të parë, në revistat e indeksuara Web of Science (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe/ose SCOPUS. Në punimet e tilla kandidati duhet të jetë si autor i parë, ndërsa përmbajtja e punimeve duhet të jetë nga rezultatet e fituara në kuadër të hulumtimeve të kandidatit në lidhje me temën e doktoratës. Me kërkesën për mbrojtje të doktoratës, kandidati dorëzon punimet e publikuara në formë të përmbledhjes së veçantë, e cila përmban hyrjen, metodologjinë dhe përfundimet kryesore të punës së kandidatit. Përmbledhja e tillë e punimeve konsiderohet ekuivalente me monografinë shkencore.
- (3) Punimi i doktoratës në lëmin artistik është hulumtim artistik original në kontekst të krijimtarisë bashkëkohore artistike dhe mbaron me prezantimin e veprës artistike si dhe me publikimin e një punimi teorik lidhur me veprën e tillë.

Neni 15

- (1) Punimi i doktoratës duhet të jetë i shkruar në gjuhën shqipe. Punimi i doktoratës mund të shkruhet edhe në gjuhën angleze, por në atë rast detyrimisht duhet të dorëzohet i përkthyer edhe në gjuhën shqipe.
- (2) Titulli, rezymeja dhe fjalët kyçe të punimit të doktoratës duhet të jenë të shkruara patjetër në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Rezymeja duhet të mundësojë të kuptuarit e qëllimit të punimit, metodave të hulumtimit, rezultateve dhe përfundimeve.
- (3) Pamja grafike e punimit të doktoratës duhet të jetë në përputhje me udhëzimet e prezantuara në formularin F5.

Neni 16

- (1) Doktoranti duhet t'ia dorëzojë këshillit të njësisë akademike punimin e kompletuar të doktoratës për vlerësim brenda 3 vjetëve nga dita kur është pranuar tema nga Senati i UP-së.
- (2) Dorëzimi i punimit të kompletuar të doktoratës bëhet së bashku me kërkesën për vlerësim të punimit.
- (3) Doktoranti mund të kërkojë nga këshilli i njësisë akademike që t'i vazhdohet periudha e disertacionit ose e kërkimeve edhe për një vit (formularin F7).
- (4) Në rast se doktoranti nuk e dorëzon punimin e kompletuar të doktoratës për vlerësim brenda periudhës së rregullt ose të vazhduar të disertacionit, konsiderohet se doktoranti heq dorë nga tema e caktuar e disertacionit.

Procedura e vlerësimit të punimit të doktoratës
Neni 17

- (1) Punimin e doktoratës, me pëlqimin dhe mendimin e nënshkruar të mentorit (i cili sipas rastit duhet të marrë parasysh edhe mendimin e mentorit tjetër ose bashkëmentorit) për hulumtimin e kryer dhe kontributin e arritur shkencor origjinal, doktoranti e dorëzon zyrtarisht në fakultet ose në universitet (nëse studimet organizohen në nivel universiteti). Në rast se mentori nuk dëshiron të japë pëlqimin, ka obligim që brenda 15 ditësh të japë me shkrim arsyetimin. Pas kësaj periudhe, në afat prej një (1) muaji pas dorëzimit të arsyetimit të mentorit, Këshilli për studime të doktoratës i njësisë akademike e shqyrton arsyetimin e mentorit dhe i propozon Këshillit të njësisë akademike formimin ose refuzimin e emërimit të komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës. Në të dyja rastet, arsyetimi i mentorit u jepet anëtarëve të komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës, të cilët do ta kenë parasysh gjatë vlerësimit.
- (2) Para se të dorëzohet punimi në procedurë për vlerësim, shërbimi i studimeve të doktoratës i njësisë akademike duhet ta vërtetojë me shkrim se doktoranti i ka kryer të gjitha obligimet, ashtu siç është paraparë me programin e studimeve të doktoratës.
- (3) Për vlerësimin e punimit doktoranti e paraqet punimin në formë të shkruar në letër dhe në formë elektronike. Te veprat artistike të doktorantit, pos prezantimit publik, doktoranti e dorëzon edhe pjesën teorike dhe dokumentacionin përkatës për vlerësimin e punimit.
- (4) Këshilli i njësisë akademike, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës, e emëron komisionin për vlerësimin e punimit të doktoratës. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë, prej të cilëve së paku njëri duhet të jetë nga ndonjë universitet jashtë Kosovës. Mentori nuk mund të jetë anëtar i komisionit për vlerësimin e punimit.
- (5) Anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës patjetër duhet të kenë së paku titullin akademik profesor asistent (prof. ass.) dhe të jenë të fushës përkatëse.
- (6) Njëherazi me emërimin e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës, njësia akademike e publikon titullin dhe rezyrenë e punimit në gjuhën shqipe dhe angleze në uebfaqen e vet, në kohëzgjatje prej 30 ditësh, dhe në këtë mënyrë mundëson që punimi t'i nënshtrohet kritikës shkencore dhe profesionale.
- (7) Anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës dhe të gjithë ata të cilëve u është mundësuar shqyrtimi i punimit të doktoratës janë të obliguar që, para se të paraqitet publikisht vlerësimi, të kenë kujdes me të dhënat dhe arritjet në punimin në fjalë, me qëllim të ruajtjes së kontributit shkencor të punimit të doktoratës si pronë intelektuale.
- (8) Komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës është i obliguar që brenda dy (2) muajve nga emërimi ta përpilojë raportin e shkruar për vlerësimin e punimit të doktoratës (formulari F8) dhe t'ia dorëzojë këshillit të njësisë akademike. Kryetari i komisionit e përgatit raportin, duke i pasur parasysh vlerësimet me shkrim të anëtarëve të komisionit, ndërkaq raportin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e komisionit. Çdo anëtar i komisionit ka të drejtë të japë vlerësim të veçantë. Raporti i komisionit duhet të përmbajë vlerësimin eksplicit lidhur me kontributin origjinal shkencor/artistik të doktorantit. Varësisht nga niveli i punimit, komisioni po ashtu mund t'i rekomandojë këshillit të njësisë akademike të kërkojë nga doktoranti plotësimin e punimit ose refuzimin në tërësi të punimit.
- (9) Në seancën e parë të radhës, këshilli i njësisë akademike, pas raportit të komisionit dhe të Këshillit të studimeve të doktoratës, vendos për:

- a) Pranimin e disertacionit në versionin e ofruar;
 - b) Kthimin prapa të disertacionin për plotësim apo për ndryshim;
 - c) Refuzimin e disertacionit për shkak të dështimit.
- (10) Në rast se disertacioni kthehet për plotësim apo për ndryshim, këshilli i njësisë akademike cakton afatin kohor prej 2 deri në 6 muaj, brenda të cilit duhet të bëhet plotësim/ndryshimi i disertacionit.
- (11) Disertacioni i plotësuar apo i ndryshuar duhet t'i dorëzohet këshillit të njësisë akademike bashkë me mendimin e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës (i cili merr parasysh edhe mendimin e mentorit tjetër ose bashkëmentorit).
- (12) Me rastin e miratimit të raportit të komisionit për vlerësim këshilli i njësisë akademike formon komisionin për mbrojtje të doktoratës. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës përbëhet nga tre anëtarë. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës mund të jetë në përbërje të njëjtë si komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës.
- (13) Vendimi pozitiv i këshillit të njësisë akademike lidhur me disertacionin, në afat prej një (1) muaji nga data e dorëzimit, shqyrtohet në KQSD, i cili, në rast të plotësimit të kushteve të parapara me këtë rregullore, i propozon senatit ratifikimin e punimit të doktoratës
- (14) Senati, në afat prej një (1) muaji nga data e rekomandimit pozitiv të KQSD-së, merr vendim lidhur ratifikimin e punimit të doktoratës.

Procedura e mbrojtjes së punimit të doktoratës

Neni 18

- (1) Doktoranti, në marrëveshje me dekanin e njësisë akademike dhe me komisionin për mbrojtje të punimit të doktoratës, detyrimisht duhet ta bëjë mbrojtjen publike të punimit të doktoratës brenda afatit prej dy (2) muajve nga dita e ratifikimit në senat.
- (2) Mentori merr pjesë në mbrojtje të punimit të doktoratës në anën e doktorantit, mirëpo nuk ka të drejtë në vendimmarrje.
- (3) Mbrojtja e punimit të doktoratës bëhet me prezencë fizike dhe është publike. Thirrja për mbrojtje publike duhet të shpallet në hapësirat e njësisë akademike, në faqen zyrtare të internetit të njësisë akademike dhe të universitetit, së paku tetë ditë para mbrojtjes. Mbrojtja duhet të organizohet në hapësirën e universitetit, gjegjësisht të njësive të tij, në gjuhën në të cilën është shkruar punimi i doktoratës. Në rast të doktoratave të dyfishta dhe të doktoratave të realizuara në kuadër të studimeve të përbashkëta, mbrojtja mund të organizohet në universitet tjetër. Procedura e mbrojtjes zhvillohet bazuar në protokollin e prezantuar në formularin F9.
- (4) Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës e bën vlerësimin menjëherë pas mbrojtjes publike të punimit të doktoratës. Vlerësimi i mbrojtjes së punimit të doktoratës mund të jetë:
- E mbrojtji me sukses të shkëlqyeshëm;
 - E mbrojtji me sukses shumë të mirë;
 - E mbrojtji me sukses të mirë;
 - E mbrojtji me sukses të mjaftueshëm;

- Nuk e mbrojt.

- (5) Në rastet kur komisioni për mbrojtje vlerëson që doktoranti ka dështuar të mbrojë doktoratën për shkak të mosrespektimit të qëllimshëm të procedurave të mbrojtjes, injorimit me dashje të komisionit për mbrojtje ose të ndonjë sjelljeje tjetër në kundërshtim me normat e zakonshme të mbrojtjes, doktoranti humb të drejtën për mbrojtje të punimit të doktoratës.
- (6) Në rastet kur komisioni për mbrojtje vlerëson që doktoranti ka dështuar të mbrojë doktoratën për shkak të përgatitjes së pamjaftueshme të procesit të mbrojtjes, dështimit në dhënien e përgjigjeve meritore në pyetjet e komisionit ose krijimit të përshtypjes së bazuar për mosnjohje serioze të materies së prezantuar në punim, komisioni mund të marrë vendim që doktorantit t'i ofrohet një periudhë prej 1 viti për përsëritje të procesit të mbrojtjes. Nëse edhe pas tentimit të dytë, doktoranti dështon të mbrojë me sukses punimin e tij, i njëjti humb të drejtën për mbrojtje të punimit të doktoratës.
- (7) Vendimi, bazuar në vlerësimin që rezulton nga procesi i mbrojtjes, merret me shumicë votash të anëtarëve të komisionit për mbrojtje të punimit të doktoratës, të konstatuara me nënshkrimin e tyre.
- (8) Për procedurën e mbrojtjes përpilohet procesverbali në gjuhën shqipe, e në rast se mbrojtja bëhet në gjuhë tjetër, procesverbali përpilohet edhe në atë gjuhë.

Heqja e titullit “Doktor i shkencave”

Neni 19

Senati, me rekomandim të rektorit, mund t'ia heqë titullin “Doktor i shkencave” bartësit në çdo kohë, nëse konstatohet:

- (1) Falsifikimi apo mashtrimi gjatë vlerësimit ose provimit;
- (2) Plagjiatura apo shkelja e të drejtave të autorit në përgatitjen e punimit të doktoratës.

Neni 20

- (1) Në rast se rezultatet e hulumtimit të punimit të doktoratës paraqesin inovacion, i cili ka nevojë të mbrohet me të drejtat e pronës intelektuale, doktoranti dhe mentori për këtë e informojnë Komisionin Qendror të Studimeve të Doktoratës. Në këtë rast, doktoranti, me pëlqim të mentorit, para se ta dorëzojë punimin e doktoratës për vlerësim, mund të bëjë kërkesë që me doktoratën e dorëzuar të veprohet në mënyrë diskrete, deri në momentin e mbrojtjes publike.
- (2) Komisioni Qendror i Studimeve të Doktoratës e zbaton procedurën për mbrojtje juridike dhe komerciale të rezultateve të hulumtimit, në pajtueshmëri me rregulloren për pronësi intelektuale. Në këtë rast, mbrojtja publike mund të shtyhet, në pajtim me doktorantin, më së largu për një vit, nga dita e ratifikimit të punimit në senat. Vendimi për shtyrje të mbrojtjes publike merret nga senati, bazuar në rekomandimin e KQSD-së dhe kërkesën e doktorantit.

Publikimi dhe ruajtja e punimit të doktoratës

Neni 21

- (1) Punimi i doktoratës në tërësi publikohet në faqet e internetit të universitetit, më së largu një muaj pas mbrojtjes. Informacioni për pjesën praktike të punimit të doktoratës nga lëmi artistik shpallet në faqe të internetit të universitetit më së largu një muaj pas mbrojtjes. Në raste të jashtëzakonshme, bazuar në arsyetimin e argumentuar mirë të të doktoruarit dhe me rekomandim të KQSD-së, senati mund të vendosë që publikimi në faqe të internetit të shtyhet deri në dy vjet.
- (2) Punimi i doktoratës në formë të shtypur ruhet në tri (3) kopje në arkivin e njësisë akademike, tri (3) kopje në arkivin e universitetit dhe tri (3) kopje në Bibliotekën Qendrore Universitare.
- (3) Punimi i doktoratës nga lëmi artistik ruhet, në përputhje me llojin e veprës, në formë adekuate (në formë të shkruar, në formë fotografie, videoregjistrimi, audioregjistrimi etj.) në arkivin e njësisë akademike, në arkivin e universitetit, në Bibliotekën Qendrore Universitare, më së largu një muaj pas mbrojtjes.

Promovimi

Neni 22

- (1) Pas përfundimit të suksesshëm të mbrojtjes së disertacionit, i doktoruari fiton titullin akademik doktor i shkencave (dr. sc.) apo ekuivalente, ndërsa të drejtat e plota të gradës akademike dhe të diplomës, me rastin e promovimit, kur edhe e bën betimin dhe nënshkruhet në Librin e doktoratës shkencore/artistike të universitetit.
- (2) Doktoranti duhet që, brenda një muaji pas mbrojtjes, ta plotësojë formularin për promovim në gradë doktor shkence/arti dhe ta dorëzojë në shërbimin e studimeve të doktoratës të njësisë akademike punimin e doktoratës, të lidhur dhe në versionin elektronik për publikim në faqen e internetit të universitetit, gjegjësisht në formë të dokumentacionit të përshtatshëm të punimit të doktoratës në lëmin artistik (forma e shkruar, fotografi, videoregjistrim, audioregjistrim etj.).
- (3) Rektori ia dorëzon doktorantit diplomën e doktoratës në promovimin solemn, në të cilin doktoranti duhet të marrë pjesë personalisht ose, në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes, ta autorizojë me shkrim një person tjetër që ta marrë diplomën për të.

Mënyra e sigurimit të cilësisë së studimeve të doktoratës

Neni 23

- (1) Shërbimi i studimeve të doktoratës i njësisë akademike është i obliguar që të kujdeset për mbajtje dhe ruajtje të shënimeve të hollësishme lidhur me punimin hulumtues dhe për kryerjen e detyrave të tjera studimore të çdo doktoranti, duke nënkuptuar këtu planin e obligimeve (përgatitja e dosjes së doktorantit), mbajtjen e shënimeve për numrin e doktorantëve të regjistruar dhe numrin e doktorantëve, të cilët e kanë mbrojtur punimin e doktoratës.
- (2) Bazuar në raportet vjetore të doktorantëve (formulari F10) dhe të mentorëve (formulari F11), këshilli i studimeve të doktoratës, për çdo vit, e përgatit raportin e vetëvlerësimit lidhur me programin e studimeve të doktoratës (formulari F12) dhe njoftimin përkatës e përcjell në këshillin e fakultetit, ndërsa ky i fundit në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës dhe senatin e universitetit.

- (3) Raporti vjetor mbi vetëvlerësimin i bashkëngjitet kërkesës për riakreditim.
- (4) Kriteret për vlerësim përfshijnë: produktin shkencor/artistik të mësimdhënësve dhe të doktorantëve, mësimdhënien, cilësinë e punimeve të doktoratës, treguesit statistikorë të kohëzgjatjes së studimeve, treguesit statistikorë të numrit vjetor të doktorëve të rinj në krahasim me numrin e doktorantëve, si dhe realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare
Neni 24

- (1) Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja për studimet e doktoratës nr. 1/775 e datës 9.09.2014 dhe vendimi për plotësim ndryshimin e asaj rregulloreje nr. 2/111 i datës 2.09.2016.
- (2) Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Senati i UP-së.
- (3) Njësitë akademike obligohen që ta hartojnë udhëzuesin sipas kësaj rregulloreje.
- (4) Formularët në vijim janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, me të cilën rregullohet edhe përdorimi i tyre:
- F1 - Paraqitja e temës dhe mentorit;
 - F2 - Vlerësimi i temës, mentorit dhe projektpropozimit të doktoratës;
 - F3 - Vendimi për aprovimin e temës së punimit të doktoratës;
 - F4 - Kërkesa për ndërrim të temës dhe/ose të mentorit;
 - F5 - Udhëzimet për përpilimin e punimit të doktoratës;
 - F6 - Kërkesa për vlerësim të punimit;
 - F7 - Kërkesa për shtyrje të mbrojtjes publike të punimit të doktoratës;
 - F8 - Raporti mbi vlerësimin e punës së doktoratës;
 - F9 - Protokolli dhe procesverbali për mbrojtjen e punimit të doktoratës;
 - F10 - Raporti vjetor i doktorantit;
 - F11 - Raporti vjetor i mentorit për përparimin e doktorantit;
 - F12 - Raporti vjetor lidhur me programin e studimeve të doktoratës;

Kryestesi i Senatit të Universitetit të Prishtinës


Prof. dr. Naser Sahiti, rektor i UP-së

